

Arbena Shehu, MA¹

UDC: 334.71.024:347.961(497.115)

334.71.024:347.961(497.7)

334.71.024:347.961(496.5)

334.71.024:347.961(497.5)

**SHOQËRITË TREGTARE NË KOSOVË, NË KONTEKST KRAHASUES ME
VENDET E RAJONIT DHE ROLI I NOTERIT NË SIGURIMIN E
TRANSAKSIONEVE EKONOMIKE**

**ТРГОВСКИТЕ ДРУШТВА ВО КОСОВО, ВО КОМПАРАТИВЕН
КОНТЕКСТ СО ЗЕМЈИТЕ ОД РЕГИОНОТ И УЛОГАТА НА НОТАРОТ
ВО ОБЕЗБЕДУВАЊЕ НА ЕКОНОМСКИТЕ ТРАНСАКЦИИ**

**TRADING COMPANIES IN KOSOVO, IN A COMPARATIVE CONTEXT
WITH THE COUNTRIES OF THE REGION AND THE ROLE OF THE
NOTARY IN SECURING ECONOMIC TRANSACTIONS**

Abstract

Commercial companies play a key role in the economic development and financial stability of any country. Creating a favorable environment for doing business is a fundamental condition for the growth of the private sector, Which in turn contributes to increased employment, income generation, and increased public revenues through taxes and contributions. State institutions have the primary obligation to establish policies and legal frameworks that support this environment, promoting the growth and development of private enterprises. At a time when the Balkan economies, including Kosovo, are aiming for EU membership, with a demand for stability, transparency, and investment, the notary plays a key role in this process, in providing legal certainty in conducting business transactions.

In order to function properly, each business company must comply with the legislation in force from the moment of its establishment and registration.

¹ Autori është student në studimet e Ciklit të tretë në Fakultetin Juridik në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë. Drejtimi E Drejta Civile.
Email: arbena.shehu@gmail.com

Given the important role of commercial companies in the economy, this paper focuses on analyzing the legal framework that regulates their activity in Kosovo and the Balkan countries.

Despite their potential, commercial companies in Kosovo face various challenges, as does the notary system in Kosovo, a relatively new system, that still faces challenges in its functioning. The role and influence of the notary are important in guaranteeing and providing legal certainty in economic transactions. However, the lack of proper state support and insufficient involvement in the design of economic policies limit the contribution of this profession to the climate of doing business in Kosovo.

Therefore, the notary plays an essential role in the establishment, modification and functioning of commercial companies, as well as in protecting the interests of the parties and the market.

This paper aims to analyze the role of the notary in economic transactions, with a particular focus on the process of establishment and functioning of commercial companies in Kosovo, North Macedonia, Albania and Croatia. From a comparative perspective, the legal and institutional similarities and differences between these countries will be examined, as well as the direct impact of the notary on legal certainty and economic development.

Keywords: *commercial companies, registration, limited liability company, business, notary.*

Hyrje

Në Republikën e Kosovës shoqëritë tregtare regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). ARBK është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës, funksionon si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë dhe ka selinë në Prishtinë. (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare, 2018, p. neni 7;) ARBK funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare që realizohet përmes lidhjes ndërmjet 34 qendrave komunale të regjistrimit (me mundësi të shtimit të tyre). (Kosovë, 2025).

Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Evropian. Konkretisht Direktiva e (BE-së) 2017/1132 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (3) përcakton, ndër të tjera, rregullat për zbulimin dhe ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të kompanive të Shteteve Anëtare.

ARBK është institucion i orientuar drejt zhvillimit që ofron arritjen e efikasitetit më të madh, me një cilësi të lartë për të gjithë operatorët ekonomik që operojnë në Kosovë.

Kjo u mundëson personave të tretë zyrtarë p.sh, bankave, institucioneve mikrofinanciare, noterëve, përmbaruesve etj. që gjatë kryerjes së transaksioneve të bizneseve, ta kenë më të lehtë të bëjnë verifikimet online të të dhënave të një shoqërie tregtare dhe të vërtetojnë ekzistimin e saj; aksionarët, përqindjen e aksioneve në mes të aksionarëve, veprimtaritë, kapitalin, adresën, selinë numrin unik identifikues, Bordin, Drejtorin dhe përfaqësuesin e autorizuar.

Roli i noterit si zyrtar publik i emëruar nga shteti, me autorizime publike që burojnë nga Ligji nr. 06/l-010 Për Noterinë (LNK) (Kosovës, 2018) për legalizimin e transaksioneve të biznesit, është krucial në themelimin e shoqërive tregtare, filluar nga këshillimi i palëve për të drejtën afariste, vërtetimin e akteve të themelimit të shoqërive tregtare, statuteve, kontratave, vendimeve të ndryshme të çdo shoqërie tregtare, verifikimi i identitetit të palëve, identifikimin e saktë të vullnetit të palëve, dhe ligjshmërinë e dokumenteve të prezantuara nga palët.

Qëllimet dhe objektivat

- Të shpjegojë legjislacionin dhe procedurat për themelimin e shoqërive tregtare në Kosovë dhe në rajon;
- Të analizojë ndikimin dhe rolin e noterit në themelimin e bizneseve;
- Të identifikojë mundësitë për avancimin e sigurisë juridike përmes kompetencave shtesë për noterin në përputhje me praktikën e vendeve të BE-së - Kroacisë;

Hipotezat

- Shoqëritë tregtare në Kosovë, në krahasim me shtetet e përfshira në analizën krahasuese;
- Rregullimi ligjor i shoqërive tregtare në Kosovë dhe praktika e Kroacisë si model i digjitalizimit të regjistrimit të bizneseve online nga noteri;
- Forcimi i rolit të noterit në transaksionet e bizneseve në Kosovë, harmonizimi me standardet evropiane;

Rëndësia e hulumtimit

Rëndësia e këtij punimi është analiza e kornizës ligjore që rregullon shoqëritë tregtare në Kosovë dhe rolin e noterit si garantues i sigurisë në transaksionet ekonomike, në **krahasim me vendet e rajonit**. Synimi është të

identifikohen zbrazëtitat ligjore, pengesat praktike dhe potencialet për reformë me qëllim përmirësimin e sigurisë juridike në të bërit biznes.

Metodologjia

Qëllimi i këtij hulumtimi është trajtimi i shoqërive tregtare në Kosovë, rregullimi ligjor dhe analiza e legjislacionit duke përdor metodën juridike, të dhëna informacione sa i përket themelimit të shoqërive tregtare, regjistrimit të tyre - metoda kualitative dhe metodën krahasuese, duke bërë krahasimin e llojeve të shoqërive tregtare në vend dhe në vendet e tjera, roli i noterit në aktet themeluese dhe transaksionet e biznesit, siguria juridike që ofron noteri, identifikimi i ngjashmërive, mangësitë në raport me zhvillimet teknologjike (digjitalizimi) dhe nevoja për rritje të transparencës institucionale.

Rregullimi ligjor i shoqërive tregtare në Kosovë

Pas pavarësisë së Republikës së Kosovës, Kosova pati mundësi të nxjerrë ligje të cilat u konsideruan si të domosdoshme për funksionimin e shoqërive tregtare në vend. Ligji aktual për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L-016 (LSHT) (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare , 2018), është i hartuar pjesërisht në harmoni me Direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, ku Republika e Kosovës ka marrë obligime me Marrëveshjen për Stabilizim Asociimin që të bëjë harmonizimin e legjislacionit me atë të BE-së. (Kosovës Q. e., 2022). LSHT i Kosovës ofron një mori rregullash të detajuara të cilat rregullojnë marrëdhëniet private ndërmjet palëve në komunitetin afarist. Gjithashtu, Ligji parasheh një procedurë të qartë për regjistrim, për ata të cilët dëshirojnë të ushtrojnë afarizëm në Kosovë. Tutje, ligji afaristëve u ofron mundësi të mjaftueshme për të zgjedhur formën e duhur të organizimit e cila i përshtatet më së miri nevojave të tyre afariste. Korniza ligjore e cila rregullon fushën e shoqërive tregtare përfshin edhe “Kodin e qeverisjes Korporative”, mbështetur në LSHT (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare , 2018, p. neni 9;) ku specifikohet që “Ministri miraton një Kod të Qeverisjes Korporative, duke përfshirë dispozitat për monitorimin dhe zbatimin e këtij Kodi” (Ministria e Industrisë, Mint.rks-gov.net, 2022) dhe një sërë udhëzimesh sikurse në vijim:

- Udhëzimi Administrativ nr. 05/2021 për regjistrimin e Zyrave të Përfaqësisë të Shoqërive Tregtare 09.06.2021; (Kosovës Q. e., Gazeta Zyrtare, 2021)
- Udhëzimi Administrativ nr. 01/2021 për regjistrimin e shoqërive tregtare; (Ministria e Industrisë, Gazeta Zyrtare, 2021)
- Udhëzimi Administrativ UA nr. 14/2020 për çregjistrimin e bizneseve në agjencinë për regjistrimin e bizneseve; (Ministria e Industrisë, Gazeta Zyrtare, 2020)

- Udhëzimi Administrativ UA nr. 01/2020 për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor në agjencinë për regjistrimin e bizneseve; (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 2020)

- Udhëzimi Administrativ UA nr. 02/2020 për procedurën e regjistrimit të emrit zyrtar dhe emrit tregtar të shoqërive tregtare. (Ministria e Industrisë, Gazeta Zyrtare, 2020)

Sipas LSHT, Kodi i Qeverisjes Korporative miratohet në formë të udhëzuesit dhe nuk përbën akt ligjor. (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare , 2018, pp. neni 9, paragrafi 7;)

Format dhe llojet e shoqërive tregtare në Republikën e Kosovës, në aspekt krahasimor me Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Kroacinë

Bazuar në dispozitat e LSHT-së në Republikën e Kosovës saktësisht kemi pesë forma të caktuara të organizimit juridik të bizneseve që paraqitën në nëntë trajta si më poshtë:

- 1) Biznesi individual B.I. - gjegjësisht ndërmarrja individuale;
- 2) Ortakëri e përgjithshme “O.P.”;
- 3) Ortakëria e kufizuar “O.K.”;
- 4) Shoqëritë komandite “SH.K.M.”;
- 5) Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara “SH.P.K.”;
- 6) Shoqëritë aksionare “SH. A”;

Përveç formave themelore të organizimit të Shoqërive Tregtare të përcaktuara në paragrafin 1 të LSHT, në ARBK regjistrohen edhe:

- 7) Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë,
- 8) Zyra e Përfaqësisë së Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë,
- 9) Ndërmarrjet publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, dhe
- 10) Ndërmarrjet shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, këto ndërmarrje deri në privatizimin e tyre administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare , 2018, p. neni 5;)

Ndërsa sipas Projekt Kodit Civil të RKS-së neni 27, kemi llojet e personave juridik, të cilët ndahen në publik dhe privat. Person juridik publik konsiderohet të jetë shteti, institucioni shtetëror, institucioni publik, ndërmarrja publike në çfarëdo forme të organizimit të saj si dhe person juridik privat është shoqata, fondacioni, shoqëria tregtare si dhe format tjera të personave juridik që parashihen me ligje të veçanta (Kosovës Q. e., n.d., pp. neni 28,29;)

Ndërsa sipas Projekt Kodit Civil të RKS-së neni 27, kemi llojet e personave juridik, të cilët ndahen në publik dhe privat. Person juridik publik konsiderohet të jetë shteti, institucioni shtetëror, institucioni publik, ndërmarrja publike në çfarëdo forme të organizimit të saj si dhe person juridik privat është shoqata, fondacioni, shoqëria tregtare si dhe format tjera të personave juridik që parashihen me ligje të veçanta (Kosovës Q. e., n.d., pp. neni 28,29;)

1. Biznesi individual (B.I.): Në biznesin individual, pronari ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet e shoqërisë. Shoqëria ka një emërtim zyrtar, përfshin EMRIN dhe MBIEMRIN e ligjshëm të pronarit dhe përfshin shkurtesën “B.I”. Biznesi individual nuk konsiderohet person juridik, po ashtu

në raport me trashëgiminë trashëgohen të drejtat dhe detyrimet por jo edhe emri i B.I.-së.

2. Ortakëri e përgjithshme (O.P.): Te ortakëria e përgjithshme, të gjithë ortakët përgjigjen pa kufizim, e në mënyrë solidare për borxhet e shoqërisë. Ortakëria e Përgjithshme ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve, duke vënë menjëherë pas tij shkurtesën “O.P.”

3. Shoqëria komandite (SH.K.M.): Në shoqëritë komandite, përveç ortakëve “të pakufizuar” (ortakët që përgjigjen pa kufizim e në mënyrë solidare për borxhet e kompanisë) marrin pjesë edhe ortakët “e kufizuar” ose ata ortakë, që përgjigjen për detyrimet e kompanisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre. Shoqëria komandite ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve, duke vënë menjëherë pas tij, shkurtesën “SH.K.M.”

4. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (SH.P.K.): Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara janë ato shoqëri që janë themeluar nga një ose disa themelues, të cilët përgjigjen për të gjitha borxhet e tyre dhe detyrimet tjera me tërë asetet. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ka një emërtim, menjëherë pas tij, shkurtesa “SH.P.K”. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë mund të regjistrojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, pa pasur nevojë të siguroj dëshmi mbi pagimin e kapitalit. Është forma më e sigurt dhe e zakonshme e regjistrimit të bizneseve e regjistrimit në Kosovë, sikurse në vendet e tjera Maqedoni dhe Kroaci, pasi që kjo formë e biznesit mbron pasurinë personale të sipërmarrësve dhe është me e thjeshtë për tu regjistruar, meqë sipas LSHT-së nuk kërkohet kapital minimal për regjistrimin e saj.

5. Shoqëritë aksionare (SH.A): Shoqëri aksionare janë ato shoqëri, kapitali i të cilave ndahet në aksione dhe që aksionaret përgjigjen për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj. Shoqëria mund të themelohet e të ketë një ose disa aksionar. Ajo ka një emërtim, prapa të cilit vihet shkurtesa “SH.A.”.

6. Kompani e huaj: Kompania e huaj është shoqëri tregtare dhe prej momentit të regjistrimit konsiderohet si dega në Kosovë që nuk ka identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm. Pas emërimit shkruhet “DEGA NË KOSOVË”. (Industrië, 2025)

Ndërmarrjet publike janë forma të veçanta juridike të themeluara nga institucionet shtetërore duke ushtruar veprimtari me interes të përgjithshëm. Këto ndërmarrje operojnë si Shoqëri Aksionare dhe janë nën mbikëqyrjen e Qeverisë, duke u organizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Pasuritë e tyre përfaqësohen në formën e aksioneve, të cilat regjistrohen në mënyrë të plotë dhe të rregullt në regjistrat përkatës. (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare , 2008)

Kooperativa Bujqësore është një entitet ligjor e krijuar nga persona fizik apo juridik janë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e tyre private në

kapitalin aksionar. Kooperativa Bujqësore themelohet nga së paku dhjetë (10) fermerë të njëjtë janë nënshkruesit e detyrimeve. (Kosovës K. i., 2003)

Regjistri i Shoqërive Tregtare në Republikën e Kosovës mënyra dhe procedura e regjistrimit në regjistrin e shoqërive tregtare

Regjistri i Shoqërive Tregtare në Kosovë rregullohet sipas kapitullit II të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016, i cili ligj parasheh regjistrin e shoqërive tregtare, të dhënat që regjistrohen, mënyrën dhe procedurat e regjistrimit. Regjistri i shoqërive tregtare është regjistër fizik dhe elektronik që administrohet nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), e cila përbën një bazë të dhënash të integruara. Regjistri tregtar ruhet në formën fizike dhe elektronike, për secilën shoqëri veç e veç e cila ka për obligim ligjor të regjistrohet. ARBK obligohet të bashkëpunojë me institucionet e administratës shtetërore për përditësimin e të dhënave të subjekteve në regjistër përmes bashkëpunimit ndërinstitucional.

Procedura e regjistrimi fillestar, regjistrimet e tjera, ndryshimi dhe plotësimi i të dhënave ekzistuese si dhe çregjistrimi në Regjistër bëhet me aplikim në cilëndo qendër të regjistrimit të ARBK-së, brenda territorit të Republikës së Kosovës ose në mënyrë elektronike dhe është e vlefshme pavarësisht vendndodhjes së selisë apo veprimtarisë së subjektit aplikues. Regjistrimi bëhet me aplikim të shoqërisë tregtare, me vendim të gjykatës apo me ndonjë bazë tjetër ligjore. Pas dorëzimit të aplikimit, ARBK shënon datën dhe orën e saktë të aplikimit, dokumenteve të pranuar, numrin e dokumenteve të dorëzuara dhe dosja nënshkruhet nga zyrtari i ARBK-së. ARBK bën regjistrimin në regjistër të çdo Shoqërie Tregtare dhe publikon në faqen e saj zyrtare në internet të dhënat, informatat apo çdo ndryshim të Shoqërive Tregtare jo më vonë se dy ditë pune pas aplikimit.

ARBK është e obliguar të pranojë dhe të përpunojë aplikimet, përfshirë regjistrimet fillestare dhe ndryshimet, nëse dokumentacioni i dorëzuar është i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Aplikuesi ka të drejtë të dorëzojë në tri gjuhë dokumentacionin për regjistrim, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Publikimi i të dhënave në ueb-faqen zyrtare të ARBK-së përbën një instrument të transparencës dhe sigurisë ligjore në marrëdhëniet afariste në Kosovë. Ky publikim përfshin të gjitha të dhënat e domosdoshme bazë për identifikimin dhe funksionimin ligjor të personave juridik, emrin zyrtar dhe numrin unik identifikues të Shoqërisë Tregtare, themeluesit, kapitalin themeltar, përfaqësuesit ligjorë dhe të autorizuarit e shoqërisë, strukturën aksionare ose ortakët, përbërjen e organeve drejtuese, adresën e selisë, llojin e shoqërisë, dokumentet themeluese dhe çdo ndryshim në statusin juridik apo organizativ të shoqërisë. Gjithashtu, në Regjistër përfshihen edhe të dhënat për shpërbërjen vullnetare, iniciimin e procedurave të falimentimit, vendimet gjyqësore

për pavlefshmërinë e shoqërisë, si dhe emërimi i përfaqësuesve në falimentim, përfshirë kompetencat e tyre nëse nuk burojnë drejtpërdrejt nga ligji.

Në regjistër evidentohen të dhënat e kërkuara me ligj ose aktet nënligjore përkatëse. Nëse aplikimi për regjistrim të Shoqërive Tregtare nuk i përmbush kërkesat ligjore, atëherë ARBK kontakton përfaqësuesin e autorizuar të shoqërisë dhe njofton për plotësim të dokumentacionit në një afat shtesë dhjetë (10) ditor. Në rast se brenda këtij afati nuk plotësohet dokumentacioni, ARBK ka të drejtë të refuzojë përmbylljen e aplikimit.

Së fundmi, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare fitojnë personalitetin juridik pas regjistrimit në Regjistër, kjo nënkupton se regjistrimi në regjistër përbën kushtin themelor për ekzistencën e tyre ligjore dhe për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në përputhje me rendin juridik në fuqi. (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare, 2018, pp. neni 15,16,17;)

Format dhe llojet e shoqërive tregtare në Maqedoninë e Veriut - regjistrimi i tyre në Regjistrin Qendror

Ndërsa nëse krahasojmë format e shoqërive tregtare në Maqedoninë e Veriut sipas Ligjit për shoqëritë tregtare “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2002, 98/2002, 42/2003 dhe 85/2003) shohim se Maqedonia e Veriut ka këto forma të shoqërive tregtare:

- 1) shoqëria publike tregtare;
- 2) shoqëria komanditore;
- 3) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar;
- 4) shoqëria aksionare; dhe
- 5) shoqëria komanditore me aksione.

1) Shoqëria publike tregtare - është shoqëri tregtare ku bashkohen dy ose më shumë persona fizikë apo juridikë, të cilët për obligimet e shoqërisë kreditorëve të shoqërisë u përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar dhe solidare me tërë pasurinë e tyre. (Jashari, 2012, p. fq. 93;)

2) Shoqëria komanditore - është shoqëri tregtare që themelohet nga dy apo më shumë persona fizikë dhe juridik, ku njëri nga bashkëpjesëmarrësit, përgjigjet për obligimet e shoqërisë personalisht me tërë pasurinë e vet, në mënyrë të pakufizuar dhe në mënyrë solidare (komplementar) dhe njëri nga bashkëpjesëmarrësit përgjigjet për obligimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të regjistruar në shoqëri (komanditor) (Jashari, 2012, p. fq.105;)

3) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar - është shoqëri tregtare, në të cilën një ose më shumë persona fizikë apo juridikë, marrin pjesë me nga një kontribut në kapitalin kryesor të shoqërisë të përcaktuar paraprakisht, mund të jenë me pjesëmarrje të ndryshme, tek kjo shoqëri tregtare bashkëpjesëmarrësit e shoqërisë nuk përgjigjen për obligimet e shoqërisë. (Jashari, 2012, p. fq.113;) Në Maqedoninë e Veriut kompania me përgjegjësi të kufizuar, është

struktura më e zakonshme e biznesit për investitorët vendas dhe të huaj për shkak të regjistrimit të thjeshtë, avantazheve të taksave dhe fillimit të shpejtë të aktiviteteve. Një ose më shumë aksionarë, por jo më shumë se 50, mund të krijojnë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me një kapital aksionar minimal prej 5,000 EUR.

4) Shoqëria aksionare - themelohet nga një apo më shumë persona fizikë dhe juridikë të vendit apo të huaj. Aksionarët marrin pjesë me kontributet në kapitalin themelor, kontributi është i ndarë në aksione. Aksionarët e shoqërisë nuk përgjigjen për obligimet e shoqërisë aksionare. (Jashari, 2012, p. fq.153;)

5) Shoqëria komanditore me aksione - shoqëri tregtare, kapitali themelor i së cilës është i ndarë në aksione dhe në të cilën një apo më shumë bashkëpjesëmarrës përgjigjen në mënyrë të pakufizuar dhe në mënyrë solidare për obligimet e shoqërisë, me tërë pasurinë e tyre (komplementar) dhe disa bashkëpjesëmarrës që kanë statusin e aksionarëve të cilët përgjigjen deri në lartësinë e kontributeve të tyre dhe bashkëpjesëmarrës që nuk përgjigjen për obligimet e shoqërisë (komanditor) (Jashari, 2012, p. fq.239;)

Maqedonia e Veriut në format e organizmit të shoqërive tregtare nuk ka Biznesin Individual (B.I.) dhe format e tjera që ka Kosova sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Regjistrimet në regjistrin tregtar bëhen në formë elektronike, regjistri tregtar mbahet në formë elektronike dhe në formë të shkruar në pajtim me Ligjin për sistem një sportel. (www.ceprosard.org.mk, 2025)

(1) Regjistri Qendror është organ i autorizuar për të kryer të gjitha regjistrimet e ndërmarrjeve dhe institucion që mban Regjistrin Tregtar. Të dhënat që regjistrohen në regjistrin tregtar janë publike, mbahen veç e veç për secilin subjekt të regjistruar.

Në Maqedoninë e Veriut ekziston sistemi online E-regjistrimi, i regjistrimit të shoqërive tregtare. Konform Ligjit për Shoqëritë Tregtare neni 82 dhe 83, Regjistri publik si libër tregtar përmban të dhënat dhe shtojcat (dokumente dhe dëshmi), për subjektet e regjistrimit për të cilat regjistrimi është rregulluar me ligj.

(2) Regjistri tregtar përbëhet nga dosja regjistruese (klaser), në të cilën regjistrohen të dhënat për regjistrim dhe përmbledhjen e shtojcave, në të cilën bashkëngjiten dokumentet dhe dëshmitë të secilit subjekt të regjistruar. Të gjitha shkresat futen në përmbledhjen e shtojcave të subjektit tregtar.

(3) Të dhënat e regjistruara dhe shtojcat e dorëzuara (dokumente dhe dëshmi) në regjistrin tregtar ruhen përherë.

(4) Agjenti regjistrues shtojcat e konvertuara (dokumente dhe dëshmi) ka për obligim t'i ruajë 5 vjet, pastaj të njëjtat t'i dorëzojë në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë. (gostivar.eregulations.org, 2025)

Nëpërmjet sistemit elektronik të regjistrimit në regjistrin qendror dhe regjistrin e personave të tjerë juridikë mund të bëhen të gjitha regjistrimet e

themelimit, ndryshimit dhe fshirjes së subjekteve të regjistrimit. E gjithë procedura mund të kryhet online nëpërmjet internetit, pa pasur nevojë për tu paraqitur në zyrat e Regjistrimit Qendror. (Liljana. J, 2023)

Roli i noterit në RMV është i rëndësishë së veçantë në themelimin e Shoqërive Tregtare, bazuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare noteri ka kompetencë, t'i vërtetojë të gjitha dokumentet e themelimit të bizneseve. Vërtetimi i akteve të biznesit nga noterit në harmoni me Ligjin e Noterisë të Maqedonisë së Veriut, përbën një ambient të sigurt për subjektet afariste dhe ju garanton sigurinë juridike në transaksionet ekonomike. (www.ceprosard.org.mk, 2025). Të gjitha aktet e themelimi të Shoqërive Tregtare që vërtetohen nga ana e noterit përfshijnë: Aktet e themelimit të shoqërive tregtare, dhurimi (vërtetimi i kontratës së dhuratës) i aksioneve nga aksionari ndaj të afërmeve të tij (trashëgimtarëve), pjesëmarrja aktive e noterit në mbledhjet e shoqërive aksionare kur në rend të ditës kemi ndryshime statusore, pjesëmarrja aktive e noterit në të gjitha procedurat e transformimeve të shoqërive nga një formë në një formë tjetër të parapara me ligj, pjesëmarrje aktive e noterit në përpilimin e përmbajtjes dhe vërtetimin e marrëveshjeve për bashkëngjitje, bashkim apo ndarje të shoqërive tregtare si dhe vërtetimin e planit për ndryshimet statusore. Nga kjo shihet se Ligji për Shoqëritë Tregtare i RMV përfshin noterin në të gjitha transaksionet e themelimit të bizneseve për dallim nga ligji për Shoqëritë Tregtare i Kosovës, i cili cek noterin vetëm në rastet e regjistrimeve të shoqërive tregtare të huaja dhe kërkon që dokumentet që vijnë nga shteti i huaj të jenë të noterizuara. Kjo situatë dhe rregullim ligjor për sa i përket Ligjit për Shoqëritë Tregtare konkretisht themelimit dhe regjistrimit të bizneseve, e vë në një hap para Maqedoninë e Veriut në raport me Kosovën.

Format dhe llojet e shoqërive tregtare në Shqipëri dhe regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB)

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në nenin 24 flet edhe për personat juridik - shoqatat dhe i ndan: në persona juridikë publikë dhe privatë. Persona juridikë publikë sipas Kodit Civil të Shqipërisë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen. Neni 26 i Kodit Civil citon: *Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.*

Shoqata fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e saj. (Shqipërisë K. P., 2013)

Në Shqipëri shoqëritë tregtare rregullohen me Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, format dhe llojet e shoqërive tregtare. Sipas LSHTSH shoqëritë tregtare janë sikurse në vijim: *shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare.*

1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkëta, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

Shoqëritë kolektive krijohen nga dy ose më shumë persona, të cilët janë përgjegjës pa kufi për detyrimet e shoqërisë, për regjistrimin e saj nuk ka kapital të përcaktuar me ligj.

Shoqëritë komandite (Sh.kom) në përmbajtjen e saj ka dy lloje ortakësh: komanditë (me përgjegjësi të kufizuar) dhe komplementarët (me përgjegjësi të pakufizuar).

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (Sh.p.k.), edhe në Shqipëri sikurse në vendet e tjera konsiderohet të jetë forma më e zakonshme për biznese të vogla dhe të mesme, kapitali minimal për regjistrim është 1 lekë. Ortakët nuk janë personalisht përgjegjës për detyrimet e shoqërisë.

Shoqëria Aksionare (Sh.a.) përdoret për biznese të mëdha dhe për ata që synojnë të mbledhin kapital nga publik, mund të jetë Sh.a. private (kapital minimal 3,500,000 lekë) dhe Sh.a. publike (kapital minimal 10,000,000 lekë).

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit (ndryshuar me ligjet: nr.9916, datë 12.5.2008, nr. 92/2012, datë 27.9.2012, nr. 8/2015, datë 19.02.2015, nr. 131/2015, datë 26.11.2015, nr. 30/2019, datë 17.6.2019; nr. 7/2022, datë 27.1.2022 (Shqipërisë K. i., Qendra e Botimeve Zyrtare, Shqipëri, 2007) “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB). Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara. Emri i tregtarit ndiqet nga shtojca “tregtar i regjistruar” ose shkurtimi përkatës “TR”. Emri i shoqërisë kolektive duhet të ndiqet nga shtojca “shoqëri kolektive” ose shkurtimin “SHK”. Emri i shoqërisë komandite duhet të ndiqet nga shtojca “shoqëri komandite” ose shkurtimin “SHKM”. Emrat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërive aksionare përmbajnë shkurtimet, të cilat tregojnë se janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “SHPK” ose shoqëri aksionare “SHA”. (Shqipërisë K. i., 2008) Hapat kryesorë për regjistrimin e një biznesi në Shqipëri janë si në vijim: Përgatitja e dokumentacionit: Akti i themelimit (statuti i shoqërisë), vendimi për

emërimin e administratorit, dokumenti i identitetit të ortakëve dhe administratorit, dëshmia e adresës së selisë, vërtetimi i kapitalit (nëse kërkohet) varësisht kërkesës për regjistrimin e llojit të shoqërisë tregtare; Aplikimi në QKB: Mund të bëhet online në portalin e-Albania (e-Albania, 2025) ose fizikisht në sportel. Aplikanti duhet të plotësoj formularin e regjistrimit dhe t'i bashkëngjis dokumentet që kërkohen konform ligjit, pajisja me NIPT (Numër Identifikimi për Personin Tatimor). QKB pas regjistrimit të shoqërisë tregtare lëshon certifikatën e regjistrimit dhe NIPT-in, vijohet me Regjistrime të tjera (sipas rastit): Në tatime, sigurime shoqërore, bashki, etj., konform llojit të shoqërisë tregtare.

Roli i Noterit në themelimin e bizneseve në Shqipëri

Angazhimi i noterit është opsional dhe ngelet në vullnetin e palëve, se a duan të noterizojnë aktet e themelimit të shoqërive tregtare, jo gjithmonë i obligueshëm, marrë parasysh se bizneset mund të regjistrohen online nga vetë aplikuesi në platformën e-Albania, kjo dhe varësisht llojit të biznesit që regjistrohet, p.sh. tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare mund të kërkohet noteri me rastin e vërtetimit të kontratave të themelimit, kur kemi të bëjmë me dhurim/transferim pasurie në natyrë, kërkohet akti notarial. Nga kjo që vijmë në përfundim se as Shqipëria sikurse Kosova përkundër digjitalizimit, nuk qëndron më mirë se në pozitën e rregullimit të kuadrit ligjor dhe roli i noterit është i mangët në këtë fushë të drejtësisë.

Format dhe llojet e shoqërive tregtare në Kroaci, regjistrimi i tyre në sistemin online Hitro.hr

Shoqëritë tregtare në Kroaci konsiderohen persona juridik, themelimi dhe forma e të cilave janë përcaktuar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kroacisë (LSHTKR) (Fletorja Zyrtare 111/1993, 34/1999, 121/1999, 52/2000, 118/2003, 107/2007, 146/2008, 137/2009, 111/2012, 111/2012/2012, 111/2012 40/2019, 34/2022, 114/2022, 18/2023, 130/2023. Sipas LSHTKR neni 3. Shoqëria tregtare mund të krijohet për të kryer veprimtari ekonomike ose ndonjë veprimtari tjetër. Shoqëria tregtare është tregtar, pavarësisht nëse kryen veprimtari ekonomike ose veprimtari tjetër. Fermerët individualë nuk janë tregtarë sipas kuptimit të këtij ligji. Krijimi i një subjekti afarist në Kroaci është një proces i rregulluar në mënyrë të detajuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Zakon o trgovačkim društvima) dhe përcakton këto shoqëri tregtare: shoqëritë tregtare publike (j.t.d.), shoqëritë komandite (k.d.), shoqëritë aksionare (d.d.), shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (d.o.o.) dhe shoqëri të interesit ekonomik (GIU) (Kroacisë, 2011, pp. neni 2, paragrafi 3;) Shoqëritë tregtare ndahen në shoqëri të perosnave ku bëjnë pjesë: Shoqëritë tregtare publike (j.t.d.), të cilat krijohen nga dy ose më shumë persona, anëtarët e saj për obligimet e shoqërisë përgjigjen me pasurinë e tyre të pakufizuar dhe janë

solidar si dhe kanë përgjegjësi të pakufizuar dhe Shoqëritë komandite (k.d.), të cilat përbëhen nga: komplementarë që përgjigjen për obligimet e shoqërisë me tërë pasurinë e tyre dhe komanditorë që përgjigjen për obligimet e shoqërisë vetëm deri në shumën e investuar, pra përgjegjësia në këtë shoqëri është sipas pozitës së anëtarëve. Shoqëritë e kapitalit ligji i liston: Shoqëritë aksionare (d.d.), kapitali ndahet në aksione, secili aksionar përgjigjet deri në shumën e investuar dhe kanë përgjegjësi të pakufizuar; Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (d.o.o.) dhe kjo formë e shoqërisë në Kroaci, sikurse në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, është forma më e zakonshme e regjistrimit të shoqërive tregtare, krijohet nga një ose më shumë persona fizikë apo juridikë, përgjegjësia e aksionarëve është e kufizuar vetëm në shumën e investuar në shoqërinë tregtare. Sipas kësaj, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar përgjigjet vetëm me pasurinë e shoqërisë dhe sipas ligjit për shoqëri tregtare, për kapital themeltar kërkohet shuma minimale prej 2,500 (dymijë e pesëqind) euro, për regjistrim në regjistrat gjyqësor. Shoqëri të tjera ligji përcakton Shoqërinë për interesa ekonomike (GIU) të cilat krijohen nga dy ose më shumë subjekte, për promovimin e aktiviteteve ekonomike, nuk ka për qëllim të krijojë fitim.

Ndërsa ligji përcakton se në cilin moment shoqëria tregtare fiton statusin e personit juridik, edhe në Kroaci sikurse në vendet e tjera të rajonit, subjekti juridik fiton personalitetin juridik dhe të drejtën për të vepruar në mënyrë të pavarur në transaksione ligjore, vetëm pas regjistrimit në regjistrin gjyqësor. Shoqëria tregtare humb statusin e personit juridik duke e fshirë atë shoqëri nga regjistri gjyqësor. (Kroacisë, 2011, p. neni 4;)

Regjistrimi i një shoqërie në Kroaci kryhet në regjistrin gjyqësor, i cili administrohet nga gjykatat tregtare. Në fazën e themelimit të biznesit është i domosdoshëm angazhimi i një noteri publik, i cili verifikon dokumentacionin mbi themelimin e një shoqërie tregtare dhe siguron ligjshmërinë e procedurës së regjistrimit përmes noterizimit të akteve të themelimit dhe dërgimit të dokumenteve për regjistrim online në platformën elektronike.

Për të përshpejtuar dhe modernizuar procesin, Kroacia ka zhvilluar platforma elektronike si HITRO.hr (e-citizens, 2025).

HITRO.hr (hitro.hr, 2025) shërben si ndërmjetës mes ndërmarrësve dhe institucioneve shtetërore, duke mundësuar themelimin e një shoqërie me ose pa praninë fizike të themeluesve, përfshirë pagesat dhe dorëzimin elektronik të dokumenteve, regjistrimin e shoqërive tregtare (d.o.o., j.t.d. etj.), tërheqjen e certifikatës nga regjistri tregtar, regjistrim në autoritetin tatimor (Porezna uprava), sigurimet shoqërore - regjistrim në fondin pensional dhe të sigurimeve shëndetësore të punëtorëve, ndihmë me lëshimin e NIP-it (numrit tatimor) dhe numrit OIB (numri personal identifikues). Ky sistem ka ndikuar dukshëm në thjeshtësimin dhe përshpejtimin e hapjes së bizneseve në Kroaci, duke përmirësuar klimën afariste dhe qasjen ndaj investimeve, veçanërisht për investitorët e huaj të cilët trajtohen në kushte të barabarta me shtetasit kroatë, për sa kohë përmbyshet kriteri i reciprocitetit ose ata vijnë nga vende anëtare të BE-së. (e-

citizens, 2025) Po ashtu përmes sistemit online Hitro.hr bëhet ndryshimi i emrit të kompanisë, ndryshimi i selisë dhe adresës, ndryshimi i aktivitetit, ndryshimi i formës juridike të biznesit. Për të filluar procesin e regjistrimit të ndryshimeve në shoqëritë ekzistuese të regjistruara në Regjistrin e Subjekteve të Biznesit, është e nevojshme të dorëzohet në zyrën e HITRO.HR një ekstrakt historik me ndryshime të regjistruara, i lëshuar dhe i vërtetuar nga gjykata tregtare ose noteri publik dhe që nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë. Pas dorëzimit të dokumentacionit merret një formular i nënshkruar që kërkohet për regjistrimin e ndryshimit të subjektit afarist në Regjistrin e Subjekteve të Biznesit pranë Entit Shtetëror të Statistikave.

HITRO.HR, pasi të shkarkojë dokumentacionin e sipërpërmendur, përfaqësuesve të shoqërive tregtare u dërgon në mënyrë elektronike një njoftim me ndryshimet e regjistruara të Entit Shtetëror të Statistikave, brenda shtatë ditëve të punës.

Po ashtu për të kryer procedurën e fshirjes së një subjekti afarist nga Regjistri i Subjekteve të Biznesit, është e nevojshme të dorëzohet në zyrën e HITRO.HR një ekstrakt historik me ndryshime të regjistruara të vërtetuar nga gjykata tregtare ose noteri publik (jo më i vjetër se 30 ditë). Me këtë rast nënshkruhet formulari që kërkohet nga aplikuesi, për të marrë Njoftimin për fshirjen e subjekteve afariste.

Roli i Noterit në themelimin e bizneseve në Kroaci

Kroacia, si anëtare e BE-së për dallim me vendet e tjera të Ballkanit, përmban sistem të avancuar të noterisë duke e ranguar noterin si garantuesin kryesor të sigurisë juridike në themelimin e bizneseve. Themelimi i shoqërive tregtare në çdo rast bëhet kryekëput në bashkëveprim me noterin, regjistrimi i shoqërive tregtare në regjistrin gjyqësor, kompletimi i dokumentacionit, dhe vërtetimit i të gjitha akteve të themelimit të shoqërisë tregtare bëhet nga noteri, të njëjtat dokumente noteri edhe i regjistron në sistemin online HITRO.HR. (Kroacisë, 2011, p. neni 4;) Noterët në shtetin e Kroacisë kanë kompetenca të gjera në transaksionet ekonomike dhe kjo e bën forcimin e stabilitetit juridik në fushën e biznesit, forcimin e autoritetit të noterit dhe ngritjen e besimit në institucionet e shtetit, në përgjithësi kjo ndikon edhe në forcimin e shtetit.

Roli i noterit si garantues në transaksionet ekonomike dhe themelimin e bizneseve në Republikën e Kosovës

Duke bërë krahasimet e noterive në rajon vijmë në përfundim se angazhimi i rolit të noterit në Kosovë në themelimin e bizneseve është i mangët. Kjo e tëra marrë parasysh se sistemi notarial në Kosovë është një sistem akoma i brishtë, i themeluar më 14 Maj të vitit 2012. Shërbimi noterial është një shërbim publik, i ushtruar nga noterët e caktuar nga Ministri i Drejtësisë

(MD) dhe rregullohet me Ligjin nr. 06/L-010 për Noterinë (LNK) (Kosovës K. i., Gazeta Zyrtare, 2018). Bazuar në LNK, në Republikën e Kosovës, shërbimi i noterisë përkufizohet si shërbim juridik dhe publik, që ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizik dhe juridik, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Në Kosovë, sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare (nr. 06/L-016), themelimi i shoqërive tregtare kërkon përpilimin e aktit themelues dhe regjistrimin në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve. Noteri është i përfshirë në legalizimin e dokumenteve, veçanërisht për shoqëritë me më shumë se një themelues. Roli i tij është më i kufizuar krahasuar me vendet e BE-së në rastin konkret Kroacinë por edhe Maqedoninë, mirëpo synohet në rritje.

Sigurimi kualitativ i mbrojtjes juridike të personave fizikë dhe juridikë paraqet detyrimin dhe nevojën, që çdo shtet të angazhohet në zhvillimin e sistemit juridik, duke hulumtuar dhe zhvilluar format më të përshtatshme për sigurimin e mbrojtjes juridike. Aplikimi i shërbimit noterial në sistemin juridik të shtetit të Kosovës, konsiderohet si veprim strategjik në reformën e sistemit juridik, detyra primare e të cilit është ndërtimi funksional dhe efikas, i bazuar në standardet juridike evropiane.

Noteri, luan një rol kyç në krijimin dhe ruajtjen e sigurisë juridike në marrëdhëniet civile dhe tregtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të një vendi.

Mirëpo përkundër kësaj dhe një praktikë ndryshe nga vendet e Ballkanit, në Republikën e Kosovës vërtetimi i akteve të themelimit të bizneseve, nuk ishte në kompetencën e noterit, andaj që nga fillimi e gjer më sot, roli i noterit në këtë fushë ngelet akoma i mangët. Me fillimin e sistemit noterial vërtetimi i akteve të shoqërive tregtare tek noteri, tek Ligji i vjetër i noterisë 03/L-010 ishte eliminuar si kompetencë, që noterët të vërtetonin transaksionet e shoqërive tregtare, kjo me rekomandimin e USAID, që bizneseve të ju krijohet një ambient më i lehtë në të bërit biznes. Kjo situatë ka vazhduar që nga fillimi i sistemit noterial e deri në vitin 2023, ku aktet e themelimit të shoqërive tregtare nuk janë vërtetuar nga noteri. Të njëjtat akte të themelimit të shoqërive tregtare, draftoheshin dhe nënshkruheshin, vetëm mes palëve kontraktuese dhe dorëzoheshin për ndryshime direkt në ARBK (Agjencinë për regjistrimin e Bizneseve). Kjo situatë ka qenë gjithmonë me risk të lartë, në dëmtimin e interesave pasurore dhe aspak e sigurt, për palët që futeshin në këto marrëdhënie juridike, pa siguri juridike, në veçanti, ata që blinin shoqëritë tregtare apo bizneset, po e njëjta situatë ka ndikuar negativisht dhe në tërheqjen e investitorëve të huaj në mungesë të infrastrukturës ligjore dhe sigurisë juridike në sferën e të drejtës tregtare.

Vlen të theksojmë se shumë shoqëri tregtare në kuadër të kapitalit të tyre, posedojnë në pronësi të tyre edhe asete - pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme. Shitja e një shoqërie tregtare bëhej me një akt privat, e cila në pronësi të saj posedonte edhe asete të paluajtshme kjo praktik pos që kishte

pasiguri të madhe juridike kryekëput binte ndesh me - Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës (mënyra e fitimit të pronësisë iustus titulus - modus aquirendi - regjistrimi në zyrat kadastrale).

Kjo gjendje merr një kahje tjetër, konkretisht më dt. 16.08.2023, kur ARBK nxjerr Vendimin me nr.582, ku thuhej, citim: “Është vendosur që Shoqëritë Tregtare gjatë aplikimit për ndryshimin e të dhënave ekzistuese në regjistrin e bizneseve, lidhur me bartjen e aksioneve dhe/apo ndërrimin e drejtorëve, të dorëzojnë në ARBK dokumentet e noterizuara apo vërtetim nënshkrimi nga noterët e licencuar nga Ministria e Drejtësisë në Republikën e Kosovës.” (Kosovës A. e., 2023) Ky vendim i ARBK-së sigurisht është rezultat i problemeve juridike që ishin paraqitur gjatë regjistrimit të shoqërive tregtare, ndryshimeve (falsifikimet e dokumenteve, falsifikimet e nënshkrimeve të palëve kontraktuese etj.). Sigurisht se kjo situatë kishte sjell edhe shumë parregullsi, probleme ligjore dhe konteste civile dhe ekonomike. Në fillim të zbatimit të vendimit kërkesa nga ARBK ishte që të vërtetoheshin aktet e themelimit, Statutet e shoqërive Tregtare, vendimet e ndryshme si dhe kontratat për tjetërsim të shoqërive tregtare/aksioneve, e të cilat përbëjnë dokumentet thelbësore në funksionimin e një subjekti tregtar. Megjithatë, pas një periudhe të shkurtër të aplikimit të procedurës së legalizimit të dokumenteve të themelimit të shoqërive tregtare nga ana e noterit, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), tani më nuk kërkon që statuti të vërtetohet nga noteri, edhe pse ky dokument përbën aktin themelor dhe rregullator të çdo shoqërie tregtare.

Vlen të theksohet se në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve publike të Ligjit të Noterisë (LNK), noteri në Kosovë, kryen shërbime të shumta sa i përket bizneseve, autorizime të ndryshme të përfaqësimit, Kontrata të hipotekës për sigurimi e detyrimeve kreditore të shoqërive tregtare, Kontrata të tjetërsimit të paluajtshmërive në pronësi të shoqërive tregtare etj. Megjithatë roli i noterit duhet të trajtohet si faktor i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm i sistemit juridik në Kosovë marrë parasysh se Noteri, luan një rol kyç në krijimin dhe ruajtjen e sigurisë juridike në marrëdhëniet civile dhe tregtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të një vendi, si një palë e tretë neutrale dhe profesionale.

Noteri është një garant i transparencës në marrëdhëniet ekonomike. Duke përfshirë një figurë neutrale në procesin e lidhjes së kontratave, sigurohet që transaksionet të kryhen në mënyrë të dokumentuar, të qartë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo rrit besimin mes investitorëve, bizneseve dhe qytetarëve dhe ul rrezikun e mosmarrëveshjeve apo keqinterpretimeve të dispozitave kontraktore.

Conclusions and recommendations

In this study, the legal gaps in Kosovo's legislation in the field of commercial law and civil law, the role of the notary in economic transactions,

compared to the countries of the region, have been highlighted. It is clearly seen that the state of Croatia is the most advanced model in all procedures for establishing commercial companies, up to the online registration of commercial companies by the notary. Also, North Macedonia, in terms of legal regulation and the role of the notary in business transactions, is quite well consolidated. Despite the positive developments in the field of commercial companies, Kosovo still needs to complete the legal framework in the Law on Commercial Companies and the Notary Law. Increasing the authorizations of notaries, ensuring access to public registers for notaries, and digitalization the notary system, will be a step forward in the development of this very important field of justice.

In this context, the role of the notary emerges as a key element in the legal assurance of economic transactions, especially in a market that aims for transparency and integration on the path to the EU. Beyond the formal function of legalizing documents, the notary must participate in the processes of founding, drafting and certifying acts of commercial companies and registering commercial companies, taking the example of the state of Croatia.

Finally, I conclude that Kosovo has space to improve the legal framework, which also enables the provision of a safe environment for foreign investments. Greater involvement of the notary in economic transactions, considering that the notary is not only an official who legalizes documents, but a guarantor of legal order and security of transactions in the market. The role of the notary also has a positive impact on the socio-economic aspect, reducing disputes between parties, preventing fraud and invalid contracts, reducing the number of cases in the courts, costly and lengthy judicial processes. Through standardization of procedures and increasing its efficiency, the notary can become a strong pillar for sustainable economic development.

Recensentë:

Prof. dr. Bedri Bahtiri

Prof. dr. Bashkim Preteni

Bibliografia:

- E drejta afariste statusore, Prof. Dr. Jashari.A, Tetovë 2012,
- E drejta tregtare, Krasniqi. A, Botimi i parë, 2021, Ligji Nr. 06/L -016
- Për Shoqëritë Tregtare
- E drejta Tregtare, Liljana. J, Snezhana. B, Shkup 2023, fq.23
- Ligji për Shoqëritë Tregtare 06/L - 016
- Ligji për Noterinë i Kosovës 06/L - 010
- Ligji Nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës
- Ligji për shoqëritë tregtare Maqedoninë e Veriut “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2002, 98/2002, 42/2003 dhe 85/2003)

- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare Shqipëri
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit (ndryshuar me ligjet: nr.9916, datë 12.5.2008
- Ligji për shoqëritë tregtare i Kroacisë Fletorja Zyrtare 111/1993, 34/1999, 121/1999, 52/2000, 118/2003, 107/2007, 146/2008, 137/2009, 111/2012, 111/2012/2012, 111/2012 40/2019, 34/2022, 114/2022, 18/2023, 130/2023
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Draft Kodi Civil i RKS
- Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- Kodi i Qeverisjes Korporative
- Marrëveshja për Stabilizim Asociim
- [https://www.wikiwand.com/sq/Agjencia_e_Regjistrimit_t%C3%AB_Bizneseve_\(ARBK\);](https://www.wikiwand.com/sq/Agjencia_e_Regjistrimit_t%C3%AB_Bizneseve_(ARBK);)
- Koncept dokumenti për shoqëritë tregtare, Prill 2022, MTI, web faqe <https://kryeministri.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2022/11/KD-per-Shoqerite-TregtareMINT.pdf>;
- Llojet e bizneseve e disponueshme ne web faqen e ARBK-së, web faqe <https://arbk.rks-gov.net/Page/32>;
- Zakon o trgovačkim društva, neni 3&4, web faqe <https://informator.hr/zakoni/10841-zakon-o-trgovackim-drustvima>;
- Deloitte legal, Doing business in Kosovo A comparative, May 2022, guide [file:///C:/Users/38345/Downloads/dttl-legal-doing-business-in-kosovo%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/38345/Downloads/dttl-legal-doing-business-in-kosovo%20(1).pdf)
- Vendim nr.582 i dt.16.08.2023, lëshuar nga ARBK, web faqe <https://www.ikaf.org/njoftim-per-shoqerite-tregtare.html>;
- Kodi i Qeverisjes Korporative, <file:///C:/Users/38345/Downloads/Kodi%20i%20Qeverisjes%20Korporative%20i%20miratuar%20me%2004072021.pdf>;
- HITRO.HR - servis Vlade Republike Hrvatske - web faqe <https://www.hitro.hr/kako-otvoriti-d.o.o.-j.d.o.o./>;